



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republik of Kosovo
Komuna e Vitisë
Opština Vitina-Municipality of Vitina



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA
 KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranuar - Primiteno Më/Đara	15-02-2019		
Nr.i organit Org.broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednosë
02-370/03-166			

ZYRA E PROKURIMIT

KONTRATË PËR FURNIZIM

Nr.prokurimit	VI657	19	57	1-3-6
Nr. brendshëm	VI657	19	001	136

TITULLI I KONTRATËS : *Furnizim me inventar për objektin e Komunës së re*

E LIDHUR NË MES TË

Operatori ekonomik	Autoriteti kontraktues
“DELFINA” NTSH, MALISHEVË	KOMUNA E VITISE
Përfaqësuar nga:	Përfaqësuar nga:
Fadil Mazreku , drejtor	Fadil ABAZI, menaxher i prokurimit



Titulli: Furnizim me inventar për objektin e Komunës së re Nr. Prokurimit: VI657-19-001-136

PJESA B: KONTRATA

KOMUNA E VITISË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njérën anë; dhe

"DELFINA" NTSH, MALISHEVË, (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për:

Furnizim me inventar për objektin e Komunës së re me numër Identifikues **VI657-19-001-136**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Furnizim me inventar për objektin e Komunës së re**

1.2 Kontrata hynë në fuqi ditën e nenshkrimit..

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **5** ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi **I Komuna e Vitisë**, do të jetë **Objekti I ri I Administratës ne Viti**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridikzioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **7,614.00 €;**

Me fjalë: **Shtatë mijë e gjashtë qind e katërmbedhjetë Euro. /**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vërtë pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtronen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[nëse kontrata përbëhet vetëm nga një dërgesë shëno]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale te pagesës pas pranimit të tërë dërgesës]

[Kontrata perbehet me shume dërgesa]

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të se cilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

E hartuar në gjuhen **Shqip**² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Ofiruesin e furnizimeve

Emri:	Fadil Mazreku	Emri:	Fadil ABAZI
Pozita:	Drejtësor	Pozita:	Menaxher i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	
Vula:		Vula:	

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i **furnizimeve** duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për **12** muaj, pas pranimit të **[furnizimeve] [shërbimeve] [punëve]**.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [*t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat*] [*të realizojë ndonjë ose te gjitha shërbimet*] [*te kryej ndonjë ose te gjitha punët*] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve]] të pa dorëzuar deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 **Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të percaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 **Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktuje pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 **Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 **Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 30 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *Gjykata themelore Gjilane-dega ne Viti* në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 **Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do të jetë Gjykata përkatëse në Viti
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe
	2.4	Porosia të bëhet 48 orë më herët, ndërsa liferimi i mallrave të kryhet brenda 48 orë më së largu nga porosia
Cilësia e furnizimeve	18.2	<i>Malli duhet të jetë i cilësisë së garantuar. Mallrat duhet te jene te kualitetit te larte, sipas kërkesave te autoritetit kontraktues, dhe tu per gjigjen formave standardeve ligjore, sipas Specifikimeve teknike..</i>
Inspektimi dhe testimi	19.2	Menaxher i kontratës Florent Ymeri
Pagesa	20.1	Pagesat përfurnizimin e kryer do të bëhen sipas faturave te furnizimit dhe urdhër blerjeve
Dorëzimi	21.3	Viti, objekti i ri i komunes
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Palet do te bejne te gjitha perpjekjet përfte zgjdhur ne menyre miqshore te gjitha mosmarveshjet qe mund te ndodhin ne mes tyre sa po te shfaqet ndonje mosmarveshje , palet do te lajmrojne njera-tjetren me shkrim per poziten e tyre ne mosmarveshje dhe per ndonje zgjdhje qe ata konsiderojne se eshte e mundhme
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata themelore Gjilan- dega ne Viti në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund organin përfte zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]. Gjykata themelore Gjilan- dega ne Viti



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republik of Kosovo
Komuna e Vitisë
Opstina Vitina-Municipality of Vitina



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESELDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr 03/L-040 (Gazeta Zvijetarit 28/2008) dhe nenit 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë 02 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, bien këtë:

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA			
Pranuar - Primitur Me/Danë			
Nr.I organit Org.broj	Numri/Broj	Shtojcë Pillog	Vlera Vrednoe
02	370/01-16		

VENDIM

PËR EMËRIMIN E MENAXHERIT PËR MBIKËQYRJEN E FURNIZIMEVE SIPAS
KONTRATËS: **Furnizim me inventar për objektin e Komunës së re; VI657-19-001-136**

I.

Florent YMERI, CAKTOHET menaxher i projektit për kontratës: **Furnizim me inventar për objektin e Komunës së re**

II.

Menaxheri nga neni 1 i këtij vendimi ka për detyrë që të bëjë:

- Menaxhimin e furnizimit të AK, të menaxhoj obligimet e AK sipas kontratës dhe të siguroj se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara,
- Të siguroj kontroll të kostove,cilësisë dhe sasisë dhe kohën e dërgesave(vonesave),
- Të siguroj arrtjen e qëllimit të kontratës,fushëveprimit, spicifikacionit dhe përgjegjësit e AK dhe Furnizuesit.
- Të dorëzoi Planin e menaxhimit të kontratës dhe monitoron kontratën nga nënshkrimi deri në skadimin e saj.
- Të pranoj furnizimet dhe pagesat e kryera nga kompania

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë dhe menaxheri nga neni 1 i këtij vendimi.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Menaxherit,
2. Operatorit,
3. Zyrës së Prokurimit,
4. Arkivit

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISE
Sokol HALITI



PJESA C: FORMULARI I PARAQITJES SË KUOTIMIT TË ÇMIMIT

Sekzioni I. Formulari i KUOTIMIT TË ÇMIMIT

Për: **KUVENDI KOMUNAL VITI** (më tej “Autoriteti Kontraktues”)

Titulli i Kontratës: Furnizim me inventar për objektin e Komunës së re

Në përgjigje të letrës suaj të ftësës për tender për kontratën e mësipërme, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Ne kemi shqyrtuar dhe pranuar përbajtjen e plotë të dosjes së tenderit Nr 657-19-57-1-3-6. Ne pranojmë dispozitat e saj në tëresinë e tyre, pa rezervim ose kufizim.

2. Cmimi i përgjithshëm i kuotimit është:

Cmimi i përgjithshëm i kuotimit në shifra: 8,290.00 €

Dhe me shkrim tetemije e dyqinde e nentedhjet Euro




3. Ky kuotim është i vlefshëm për një periudhë prej 30 dite nga data përfundimtare për dorëzimin e kuotimit të çmimeve.

4. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Ne gjithashtu plotësish të rrisim dhe pranojmë se ndonjë informacion të pasaktë ose të paplotë të dhënë me qëllim në këtë aplikacion mund të rezultojë në përjashtimin tonë nga kjo dhe kontrata të tjera të finançuara nga BKK.

5. Çmimi i përgjithshëm i kuotuar është fiks dhe nuk i nënshtrohet ndonjë ndryshimi gjatë kontratës (duke përjashtuar çmimet e këtyre artikujve që janë subjekt i rregullimeve të çmimeve në bazë të shkëmbimit të aksioneve përkatëse). Çmimi i përgjithshëm i kuotuar specifikohet dhe është i bashkangjitur në Specifikimet e Çmimit.

DORËZUAR NGA:

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISE	N.T.P. "BURIMI DEKOR"
ADRESA E PLOTE	RR.OSMAN E IMER SYLA – VUSHTRRI, PESTOVE
PERFAQESUAR NGA:	
EMRI	BURIM PERQUKU
POZITA	DREJTORE
NENSHKRIMI	
DATA	21.01.2019
VULA	

Sekcioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

Nr. i Artikullit.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njesi DDP ⁶ - €	Çmimi total €	Koha e dërgesë
1.						
2.						
3.						
etj						

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISE	N.T.P. "BURIMI DEKOR"
ADRESA E PLOTE	RR.OSMAN E IMER SYLA – VUSHTRRI, PESTOVE
PERFAQESUAR NGA:	
EMRI	BURIM PERQUKU
POZITA	DREJTORE
NENSHKRIMI	
DATA	21.01.2019
VULA	

⁶ Detyrimi i Dorëzimit është Paguar - Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare.

PARAMASA E FURNIZIMIT ME INVENTAR TË ZYREVE TE KOMUNA E RE

Nr	Përshkrimi i furnizimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.1	Furnizimi dhe Vendosja e Sporteve pritëse për personelin e komunës - shërbYESIT civil , në zyrat pritëse të komunës.(Furnizimi të bëhet sipas vizatimeve të prezantuara në projekt , duke aprovuar mostrat nga organi mikqyrës).	copë	27.00	130.00 €	3,510.00 €
1.2	Furnizimi dhe Vendosja e ulëseve për personelin e komunës - shërbYESIT civil , në zyrat pritëse të komunës.(Furnizimi të bëhet sipas vizatimeve të prezantuara në projekt , duke aprovuar mostrat nga organi mikqyrës).	copë	27.00	60.00 €	1,620.00 €
1.3	Furnizimi dhe Vendosja e ulëseve për qytetarët .(Furnizimi të bëhet sipas vizatimeve të prezantuara në projekt , sipas nevojës nga dy tri dhe katër ulëse të bashkuara sipas vendit ku vendosen duke aprovuar mostrat nga organi mikqyrës).	copë	28.00	45.00 €	1,260.00 €
1.4	Furnizimi dhe Vendosja e ulëseve për sallën e kuvendit .(Furnizimi të bëhet sipas vizatimeve të prezantuara në projekt , duke aprovuar mostrat nga organi mikqyrës).	copë	20.00	95.00 €	1,900.00 €
			Shuma 2 :	8,290.00 €	

REKAPITULLIMI

1	Furnizimi me inventar i zyreve pritëse	
	SHUMA TOTALE :	8,290.00 €

Vorjduan 3. 1. 2019

2. Reag.

3. Kusht

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	N.T.P. "BURIMI DEKOR"
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TE OE:	BURIM PERQUKU
NËNSHKRIMI:	
DATA:	21.01.2019
VULA:	